

URDHËR
Nr. 133, datë 18.7.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 22, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë” dhe ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Brendshëm, drejtorit të Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, z. Bledar Skënderi, për datën 19.7.2022 për këtë çështje:
 - nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues për fitimin e shtetësisë shqiptare pranë Presidentit të Republikës.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, z. Bledar Skënderi.
3. Këto kompetenca do të ushtrohen për datën e sipërcituar, me ndërprerje vetëm në rast kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi